

Jeanes Pleuro
Juh

KUVENDI
NR 1610 DATE 25.04.24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .04.2024

Lënda: Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligj.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Proçedurës Penale të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, shoqëruar me relacionin përkatës, të propozuar nga një deputet i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

KRYETARI

Lulzim Basha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ
Nr. ____/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
LIGJIN NR.7905, DATË 21.3.1995 “KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË” I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 2 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin Nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Proçedurës Penale të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Neni 1

Pas pikës 1 të nenit 470 shtohet pika 1/1 me me përmbajtjen si më poshtë:

“1/1 Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve të dhëna prej saj.”

Neni 2

Pas nenit 492 shtohet neni 492/1 me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 492/1

Kompetenca lëndore për shqyrtimin e kërkesave për ekstradim

- Ministria e Drejtësisë kur konstaton se vepra penale që i ngarkohet personit për të cilin kërkohet ekstradimi përfshihet në dispozitat e nenit 75/a të këtij Kodi dhe në nuk e refuzon kërkesën për ekstradim, ia përcjell aktet brenda 10 ditëve prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.*
- Ministria e Drejtësisë në të gjitha rastet e tjera përveç atyre të përcaktuara në pikën 1, kur ka një kërkesë për ekstradim dhe nuk e refuzon atë, ia përcjell aktet brenda 10 ditëve prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin personi për të cilin është kërkuar ekstradimi, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm.*

Neni 3

Në pikën 5 të nenit 493, fjala “rrethit” zëvendësohet me “shkallës së parë”.

Neni 4

Në nenin 494 pika 3 ndryshohet si vijon:

“3. Masa vendoset nga gjykata që ka kompetencën lëndore sipas veprës penale Kompetenca tokësore për të vendosur masën u takon, sipas radhës, gjykatës së shkallës së parë në territorin e së cilës personi ka vendbanimin, vendqëndrimin apo banesën ose gjykatës së rrethit gjyqësor ku ai gjendet. Në qoftë se kompetenca nuk mund të përcaktohet në mënyrat e treguara më sipër kompetente është Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë”.

Neni 5

Në nenin 495, pika 2, fjalia e dytë ndryshohet si vijon:

“Brenda dyzet e tetë orëve prokurori e vë të arrestuarin në dispozicion të gjykatës kompetente, duke i dërguar edhe dokumentacionin përkatës. Kur kompetenca i përket gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm, prokurori e vë të arrestuarin në dispozicion të gjykatës në territorin e së cilës është bërë arrestimi”.

Neni 6

Në nenin 504 pika 1, fjalia e dytë, fjalët “në territorin e së cilës” zëvendësohen me “në të cilën”

Neni 7

Në nenin 506, pika 2, fjala “i rrethit” zëvendësohet me fjalët “pranë gjykatës kompetente”.

Neni 8

Në nenin 508 pika 1, fjalët “të rrethit përkatës” zëvendësohet me fjalët “pranë gjykatës kompetente”.

Neni 9

Pas pikës 1 të nenit 512 shtohet pika 1/1 me me përmbajtje si vjon:

1/1. Ministria e Drejtësisë, kur i vjen një vendim penal i dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë, të huaj ose pa shtetësi, por me banim në shtetin shqiptar, ose ndaj personave të proçeduar penalisht në shtetin shqiptar, sipas parashikimeve të nenit 75/a të këtij Kodi, i dërgon Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, një kopje të vendimit dhe dokumentacionin përkatës, bashkë me përkthimin në gjuhën shqipe.

Neni 10

Në nenin 512 pika 3 ndryshohet si vijon:

“3. Prokurori i bën kërkesë gjykatës kompetente për njohjen e vendimit të huaj. Nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë ai mund t’u kërkojë autoriteteve të huaja informacionet që i çmon të nevojshme.”

Neni 11

Në nenin 515, në pikat 3 dhe 4, fjalët “*e rrethit gjyqësor*” zëvendësohen me “*kompetente*”

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYETARJA
Lindita NIKOLLA